


Bibël për fëmijët
paraqet

Jezusi dhe
Llazari



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: Janie Forest

Adaptuar nga: Ruth Klassen

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi

Prodhuar nga: Bible for Children

www.M1914.org

©2013 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori, nëse nuk do ta shitni.



Maria dhe Martha ishin
të shqetësuara.
Vëllai i tyre,
Llazari, ishte
i sëmurë -
shumë i
sëmurë.




Motrat e dinin që Llazari
mund të vdiste
së shpejti.
Ato i çuan
fjalë Jezusit.




Ai e donte
këtë familje
të vogël nga
Bethania.



Kur Jezusi dëgjoji rreth Llazarit,
Ai u tha dishepujve të Tij: "Kjo
sëmundje nuk do të përfundojë në
vdekje".



Megjithëse Jezusi ishte shumë kilometra larg, Ai e dinte saktësisht çfarë do ti ndodhte Llazarit.



Jezusi priti dy ditë, përpara se të nisej për në Bethani. Pastaj Ai tha diçka që i la pa gojë dishepujt e Tij.



“Llazari ka vdekur. Unë jam i gëzuar që nuk isha atje, në mënyrë që ju të mund të besoni”.



Çfarë do të thonin këto fjalë kaq të çuditshme? Çfarë kishte në plan për të bërë, Jezusi?




Kur Jezusi
mbërriti në
Bethani, Llazari
kishte v
dekur

qysh
katër
ditë
përpara.



Trupi i tij
i mbështjellë
me rroba
varrimi, ishte
brenda një

shpelle-varr.



Martha shkoi për të takuar Jezusin.
“Vëllai yt do të ringjallet sërish”,
tha Jezusi.



“E di - në ringjalljen, ditën e fundit”
u përgjigj Maria.



Ajo mendoi se duhej të priste gjer
në fund të kohërave për ta parë
Llazarin sërish.



Por Jezusi kish ndërmend diçka
ndryshe.





"Unë jam
ringjallja
dhe jeta", i tha
Jezusi Martës.





"Ai që beson në mua, edhe nëse vdes do të jetojë". Marta i besonte Jezusit.






Ajo e dinte që
Ai është Biri
i Perëndisë.
Por si mund ta
ndihmonte Ai,
Llazarin?



Çdokush ishte i trishtuar për shkak të vdekjes së Llazarit. Motra e tij, Maria, po qante.



Edhe miqtë që përpiqeshin ta
ngushëllonin atë, qanin. Edhe
Jezusi qau.



Jezusi shkoi me
njerëzit tek varri.
Një gur i madh
ishte mu

përpara
hyrjes
së varrit.



"Hiqeni gurin," urdhëroi
Jezusi. "Zot",
u përgjigj
Marta, ...



... "tashmë ai po kundërmon, sepse ka vdekur qysh prej katër ditësh".



Me
urdhërin
e Jezusit
njerëzit e
larguan gurin
tutje. Atëherë
Jezusi iu lut Atit
të Tij qiellor.



Jezusi
ishte përpara
kryerjes së
një mrekullie aq
të madhe, sa që
njerëzit do ta
kuptonin se Ai
ishte dërguar
nga Perëndia.



"Lazar",
thirri Jezusi.
"Dil jashtë".
Njerëzit në
ato çaste do
kenë qënë duke
vështruar varrin
të mahnitur.



A mundet
Jezusi të
bëjë një të
vdekur të
jetojë?





PO!
Llazari
doli
jashtë
shpellës, ...





... i tëri i
mbështjellë
me rrobat e
varrit - I
GJALLË!

"Zgjidheni", tha Jezusi. "Dhe lëre ni të shkojë".



Çfarë gëzimi që ishte!
Lotët u kthyen
në të qeshura.



Jezusi e kishte
mbajtur fjalën
e Tij.




Llazari ishte i gjallë përsëri.



Vetëm Biri i Perëndisë
mund ti jepte jetë një
njeriu të vdekur.



Shumë njerëz që panë këtë mrekulli
i besuan Jezusit. Por disa të tjerë e
spiunuan tek armiqtë
e Tij - drejtuesit e
tempullit.



Plot xhelozi ata thurën ligësisht
një plan për ta vrarë Jezusin. Kur
Jezusi e mori vesh këtë,
u largua prej andej për
njëfarë
kohe.



Jezusi dhe Llazari

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Gjonit 11

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130



Fund



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëjë atë! Ai do të vijë dhe do të jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.



Nëse ti beson se kjo është e
vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i
bërë njeri për të vdekur për mëkatet e mia,
dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem, eja në
jetën time dhe fal mëkatet e mia, në mënyrë
që unë të kem jetë të re dhe një ditë të jem
me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo, të të bindem
dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë
çdo ditë! Gjoni 3:16

